

## **Klauzola e Arbitrazhit**

Zgjidhja e mosmarrveshjeve me procedurën e arbitrazhit është e mundur vetëm kur palët kanë parashikuar në kontratë, apo në cdo formë tjetër komunikimi, vullnetin e tyre për ndjekjen e procedurës së arbitrazhit. Ky detyrim ligjor parashikohet nga neni 403 i Kodit të Procedurës Civile i cili përcakton se: **“Mund të gjykohet me procedurë arbitrazhi vetëm në qoftë se ekziston një marrëveshje e palëve, me anë të së cilës ato pranojnë t’ia nënshtrojnë arbitrazhit mosmarrëveshjet që kanë lindur ose mund të lindin nga një kontratë e lidhur ndërmjet tyre.”**. Forma e marrveshjes (klauzolës) së arbitrazhit parashikohet nga paragrafi i parë i nenit 404 të Kodit të Procedurës Civile i cili përcakton se: **“Është i pavlefshëm kushti për gjykimin e mosmarrëveshjes me arbitrazh, kur nuk pasqyrohet me shkrim në vetë marrëveshjen kryesore të palëve ose me një dokument tjetër të shkruar që i referohet asaj, siç mund të jetë telegrami, teletaksi e çdo mjet tjetër i saktë që përbën provë shkresore.”**. Ndonëse neni shpreh rastet e pavlefshmërisë së marrveshjes (klauzolës) së arbitrazhit rezulton se një marrveshje (klauzolë) arbitrazhi duhet detyrimisht të jetë në formë të shkruar duke respektuar kushtet e parashikuara nga Kodi i Procedurës Civile për shkresat dhe provat shkresore.

Procedura e arbitrazhit fillon me paraqitjen e kërkesës nga paditësi pranë Dhomës Shqiptare të Arbitrazhit, e cila nga ana e saj, përpara fillimit të procedurës së caktimit të arbitrave, është e detyruar që të vlerësojë prima facia nëse marrveshja (klauzola) e arbitrazhit është e vlefshme. Kushtet për vlefshmërinë e klauzolës së arbitrazhit parashikohen nga neni 404 i Kodit të Procedurës Civile i cili, përvec sa analizuar më lartë për formën e marrveshjes (klauzolës) së arbitrazhit, në paragrafin e dytë të tij përcakton se: **“Marrëveshja e palëve, sipas paragrafit të parë, është e pavlefshme, në rast se në atë nuk caktohet arbitri apo arbitrat, nuk parashikohet mënyra e caktimit të tyre, si dhe objekti i mosmarrëveshjes, kur ajo efektivisht ka lindur”**. Në analizë të dispozitës së mësipërme rezulton se kushtet që një marrveshje (klauzolë) arbitrazhi të jetë e vlefshme janë: a) forma e shkruar e marrveshjes (klauzolës); b) numër përcaktohet numri i arbitrave; c) nuk përcaktohet procedura e caktimit të arbitrave dhe d) nuk përcaktohet objekti i mosmarrveshjes, në rastet kur marrveshja e arbitrazhit lidhet pas lindjes së mosmarrveshjes ndërmjet palëve.

Me qëllim përcaktimin paraprak kontraktual të vullnetit të palëve për zgjidhjen e mosmarrveshjeve të mundshme me procedurën e arbitrazhit Dhoma Shqiptare e Arbitrazhit sugjeron që në kontrata e lidhura ndërmjet palëve të përfshihet në dispozitat për zgjidhjen e mosmarrveshjeve një nga modelet e mëposhtme të klauzolave të arbitrazhit.

## **Modeli A**

Për gjitha mosmarrveshjet që mund të lindin nga zbatimi i kësaj kontrate/marrveshje Palët do përpiqen t’i zgjidhin me anë të Pajtimit dhe Ndërmjetësimit të ofruar nga Dhoma Shqiptare e Arbitrazhit. Në rast se përpyekja dështon, mosmarrveshjet, qoftë edhe të natyrës jashtëkontraktore, që rrjedhin nga kjo kontratë/marrveshje do të zgjidhen me arbitrazh, sipas Rregullave të Dhomës Shqiptare të Arbitrazhit nga një arbitër i vetëm, i emëruar në përputhje me këto Rregulla.

## **Modele B**

Për gjitha mosmarrveshjet që mund të lindin nga zbatimi i kësaj kontrate/marrveshje Palët do përpiqen t'i zgjidhin me anë të Pajtimit dhe Ndërmjetësimit të ofruar nga Dhoma Shqiptare e Arbitrazhit. Në rast se përpyekja dështon, mosmarrveshjet, qoftë edhe të natyrës jashtëkontraktore, që rrjedhin nga kjo kontratë/marrveshje do të zgjidhen me arbitrazh, sipas Rregullave të Dhomës Shqiptare të Arbitrazhit nga tre arbitra, të emëruar në përputhje me këto Rregulla

## **Modeli C**

Të gjitha mosmarrëveshjet, kundërshtimet ose pretendimet që do të lindin nga zbatimi i kësaj kontrate/marrveshje ose në lidhje me të ose shkeljen, përfundimin ose pavlefshmërinë e saj do të zgjidhen me arbitrazh, sipas Rregullave të Dhomës Shqiptare të Arbitrazhit nga një arbitër i vetëm, i emëruar në përputhje me këto Rregulla.

## **Modeli D**

Të gjitha mosmarrëveshjet, kundërshtimet ose pretendimet që do të lindin nga zbatimi i kësaj kontrate/marrveshje ose në lidhje me të ose shkeljen, përfundimin ose pavlefshmërinë e saj do të zgjidhen me arbitrazh, sipas Rregullave të Dhomës Shqiptare të Arbitrazhit nga një tre arbitra, të emëruar në përputhje me këto Rregulla.

## **Modeli E**

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin ose do të lindin nga zbatimi i kësaj kontrate, që rrjedhin prej saj, apo të lidhura me të do të zgjidhen me arbitrazh. Institucioni i arbitrazhit është Dhoma Shqiptare e Arbitrazhit. Arbitrazhi do të zhvillohet sipas Rregullave Procedurale të Dhomës Shqiptare të Arbitrazhit, nga një arbitër, i caktuar sipas këtyre rregullave. Gjuha e arbitrazhit është gjuha shqipe. Vendi i arbitrazhit është Tiranë. Legjislacioni i zbatueshëm është legjislacioni shqiptar

## **Modeli F**

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin ose do të lindin nga zbatimi i kësaj kontrate, që rrjedhin prej saj, apo të lidhura me të do të zgjidhen me arbitrazh. Institucioni i arbitrazhit është Dhoma Shqiptare e Arbitrazhit. Arbitrazhi do të zhvillohet sipas Rregullave Procedurale të Dhomës Shqiptare të Arbitrazhit, nga një trupë prej tre arbitrash, të caktuar sipas këtyre rregullave. Gjuha e arbitrazhit është gjuha shqipe. Vendi i arbitrazhit është Tiranë. Legjislacioni i zbatueshëm është legjislacioni shqiptar.